

**STATUTI I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ALTER CS" SH.P.K.**

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Në bazë të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" dhe ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Trgetare", me vullnetin e tyre të lirë, ortaket:

1. Andis Driza – lindur në Tirane, me adresë Rr. Ali Demi, Pall. Vind, Tiranë; pjesa në pronësi 50,000.00 leke.

2. Vjollca Malushi – lindur në Tiranë, me adresë Rr. Irfan Tomini, Pallati 11, Shkalla 11, ap. 9, Tirane, me ID ; pjesa në pronësi 50,000.00 leke.

si themelues të kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të kufizuar, vendosën të hartojnë këtë Statut, mbështetur në parimet e mëposhtëme:

KREU II

EMRI, STATUTI, SELIA, KOHEZGJATJA

NENI 2

Formohet shoqëria tregëtare e emërtuar "ALTER CS" sh.p.k. dhe me emërtimin e shkurtuar "ALTER CS"sh.p.k.

NENI 3

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojnë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të tyre të nëshkruara për kapitalin.Përgjegjësia e ortakëve është deri në kontributin e tyre në kapitalin themeltar;

NENI 4

Seli e Shoqerise "ALTER CS" SH.P.K do te jetë ne Tirane, ne adresen: Rr. Irfan Tomini, Pallati 11, Shkalla 11, ap. 9, Tirane, Shqiperi. Me miratim te organeve të saj kompetente ajo mund të ndryshojë selinë. Mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e R.SH apo jashtë saj.

NENI 5

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pa caktuar.

KREU III

O B J E K T I

NENI 6

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:



Sherbime Keshillimi, Menaxhimit te Projekteve, te Edukimit dhe trajnimit ndaj te treteve nefushen e teknologjise se informacionit dhe komunikimit, burimeve njerezore, ekonomike, financiare, te biznesit dhe investimeve, te marketingut, te promovimit, studimeve te tregut, nefushen e kerkimit dhe botimit shkencor. Aktivitet nefushen e ndermjetesimit per rekrutim dhe punesim. Sherbime per ndermjetesimin e udhetimeve. Aktivitet ne prodhimin e sherbimeve dhe zgjidhjeve informatike per tregun lokal dhe te huaj.


Dizenjim software. Analize, projektim i arkitektures se nje sistemi software; Zhvillim dhe mirembajtje sistemesh software. Programimi i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i te gjitha komponenteve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet dhe mirembajtja e te gjitha komponenteve, suporti i sistemit; Testim software. Testim i funksionaliteteve, ngarkeses ne pune, performances, disponueshmerise dhe sigurise se sistemit software; Dizenjim dhe zhvillim sistemesh komunikimi. Analize, planifikim, projektim, zbatim, vendosje ne pune dhe mirembajtje e sistemeve te komunikimit te rrjeteve te pajisjeve informatike; Dizenjim dhe zhvillim sistemesh te sigurise. Analiza e kerkesave te sigurise se klientit, projektimi i arkitektures, instalimet dhe konfigurimet e komponenteve, vendosja ne pune, testimet e 2 sigurise dhe mirembajtja; Zhvillim sistemesh migrimi. Transferimi i te dhenave dhe infrastruktures perkatese nga nje teknologji e vjeter ne nje teknologji te re; Permirsim/upgrade sistemesh informatike; Operimi, menaxhimi, suporti i perdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik per sistemet software. ;

Sherbime te ndryshme, ne favor te te treteve, si konsulenca, sherbime ne fushen administrative, kontrollit sasior dhe cilesor te mallrave (spontime). Spedicion te mallrave te import -exportit, tranzite ne territorin e Republikes se Shqiperise. Import-export, tregtimi i mallrave te ndryshem, lende te para, materiale elektrike, makineri e pjese kembimi te te gjitha llojeve, pajisje elektrike, pajisje kompjuterike. Shoqeria pervec sa me siper, mund te shes, te blej, dhe te marr pjese ne formen e aksioneve ose jo edhe ne te tjera shoqeri vendase ose te huaja, te cilat kane objekt te njejte veprimtarie ose te ngjashme me te. Shoqeria mund te kryej te gjitha operacionet mbi pasurine e luajtshme dhe te paluajtshme. Perfshire ketu ato financiare, tregtare, sherbimit te vleresimit te pasurive (te luajtshme dhe te paluajtshme) te lidh kontrata te dyanshme aktivi dhe pasivi me insitutet e kreditit te autorizuara nga ligji dhe me shoqerite dhe firmat private, te jape garanci reale edhe per te tretet dhe gjithcka qe eshte e nevojshme per realizimin e objektit te veprimtarise se shoqerise. Dhenie me qira te treteve, makineri, pajisje, mjete transporti etj. Konsulence ne fushen juridike, tregtare dhe financiare. Konsulenca te ndryshme biznesi, studime te ndryshme, trajnime te ndryshme, dhe sherbime te tjera. Organizime te praktikave profesionale dhe mesimore. Agjensi punesimi, rekrutim, trajnim i burimeve njerezore. Organizim i praktikave te punes, punesim stafi per palet e treta. Aktiviteti "sherbime telefonike per klientet jashte territorit te Republikes se Shqiperise (Call Center)

KAPITALI

NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 lek dhe perbehet nga 2 (dy) kuota nga 50,000 Lekë secila me kontributet e ortakëve si me poshtë:



Emri	Perqindja %	Kuota (pjesë)	Shuma e kapitalit
Andis Driza	50 %	1	50,000
Vjollca Malushi	50 %	1	50,000

Kapitali themeltar është tërësisht në para. Të gjitha kuotat e kapitalit themeltar janë nënshkruar dhe shlyer krejtësisht nga ortakët themelues.

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve, por asnjëherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

NENI 8 KUOTAT E KAPITALIT

Kuota e kapitalit të shoqërisë mund të zotërohet nga një ose më shumë persona.

Në rastin kur një kuotë e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person, në marrëdhënie me shoqërinë këta persona trajtohen si një ortak dhe të drejtat e tyre ushtrohen, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët. Këta persona përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet që lindin nga zotërimi i kuotës.

Veprimet e shoqërisë ndaj kuotës së zotëruar nga më shumë se një person krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të saj edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve.

Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit. Kjo certifikatë lëshohet në emër të personit apo të personave, që zotërojnë kuotën dhe nuk përbën letër me vlerë.


NENI 9 MËNYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE

Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Ortakët mund t'u shesin të tretëve kuotat e tyre të kapitalit pjesërisht ose tërësisht, por pasi tua kenë ofruar për blerje ortakevë brenda shoqërisë me kushte jo më pak të favorshme nga ato që do j'u ofrohen të tretëve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakëve të cilët kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë të cilën duhet ta ushtrojnë brenda 30 ditëve nga data e komunikimit në të kundërt oferta konsiderohet e refuzuar prej ortakëve që gëzojnë këtë të drejtë.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit në QKR.

Kuotat janë të papjestueshme.
Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

KREU IV

ORGANET E SHOQËRISË

NENI 10

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Asambleja e përgjithshme
- Administratori

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

NENI 11

KOMPETENCAT

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të çështjeve të mëposhtëme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të këtij neni;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- gj) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- h) të kryejë detyra të tjera të parashikuara nga ligji.

NENI 12

MBLEDHJA E ASAMBLESE

Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë vendimor. Ajo mbledhet sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë si dhe për të gjitha rastet e parashikuara në nenin 82 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 për “Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori ose ortatakët. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithëshme thirret të paktën një herë në vit.

NENI 13

THIRJA DHE VENDIMARRJA NË ASAMBLE



Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose në me postë elektronike në adresën që secili ortak ka përcaktuar në rregjistrin e ortakëve. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 35 % të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës (shumicë e kualifikuar), për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera të renditura në nenin 11 të këtij Statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Nëse janë mundësitë ortakët mund të marrin pjesë në Asamble edhe nëpërmjet mjeteve elektronike.

Të gjitha vendimet e Asamblesë regjistrohen në procesverbal i cili përmban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

ORGANI ADMINISTRATIV

NENI 14

Administrator i shoqërisë "ALTER CS" SH.P.K . është Znj. Belinda LALA, e bija Imer dhe Kujtime, lindur në Peshkopi. më 27/03./1988, me karte identiteti I85327061N, dhe banues në Tiranë

NENI 15

KOMPETENCAT

Asambleja e Përgjithshme emëron administratorin e shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhje.

Administratori ka këto kompetenca:

a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) të përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesi këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë

mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) të kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) të raportoj përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

f) është i detyruar të ruajë kofidencialitetin e të dhënave të shoqërisë edhe pas mbarimit të mandatit të veprimtarisë së tij.

Administratori është kompetent edhe për të:

- realizuar mbledhjen e asamblesë duke njoftuar ortakët me shkrim jo më vonë se 7 ditë më parë;
 - propozuar strukturën e aparatit të shoqërisë;
 - marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta;
- Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

KREU V

PRISHJA E SHOQËRISË

NENI 16

Shoqëria "ALTER CS" sh.p.k prishet:

a) me vendim të asamblesë së përgjithshme;

b) me hapjen e procedurave të falimentimit;

c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në QKR;

ç) me vendim të gjykatës;

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë sjell hapjen e procedurave të likuidimit. Gjate fazes së likuidimit emrit të shoqërisë i shtohet pjesa "Ne likuidim" që shenohet në të gjitha dokumentet që shoqëria nxjerr gjate kesaj perjudhe.

Likuiduesi i emruar nga Asambleja e Përgjithshme, kërkon çregjistrimin e shoqërisë pranë QKR, pas shperndarjes së aktiveve të mbetura të shoqërisë.

VITI FINANCIAR

NENI 17

Ne përputhje me ligjin shoqëria do të ketë një regjister në të cilën mbahen balance vjetore, raporte financiare vjetore dhe çdo kërkesë tjetër ligjore.

NENI 18

Viti financiar i shoqërisë fillon në 1 janar të çdo viti kalendatarik dhe përfundon në 31 dhjetor të po këtij viti me përjashtim të vitit të regjistrimit ku viti financiar fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë dhe përfundon në 31 dhjetor.

DIVIDENTËT

NENI 19

Kur rezultati financiar i shoqërisë i pasqyruar në bilancet financiare është pozitiv, pas miratimit të bilancit vjetor dhe shpërndarjes së të ardhurave, Asambleja përcakton shumën që do të ndahet si dividendë, bazuar në kuotat që zoteron çdo ortak.

PARASHIKIME PERFUNDIMTARE

NENI 20

NENSHKRIMI I KAPITALIT TE ORTAKËVE

Kapitali i ortakëve nënshkruhet dhe ekzekutohet në përputhje me kuotat respektive të ortakëve të shoqërisë si më poshtë:

Emri	Perqindja %	Kuota (pjesë)	Shuma e kapitalit
Andis Driza	50 %	1	50,000
Vjollca Malushi	50 %	1	50,000

NENI 21

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij statuti, dhe aktit bashkëlidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëria ka vulën e vetë në të cilën shkruhet emri i shoqërisë siç e prashikon ligji. Për ato që nuk janë parashikuar në këtë statut zbatohen dispozitat e ligjit.

Statuti është hartuar në 3 (tre) kopje origjinale me të njëjten fuqi ligjore.

ORTAKËT

1 Andis Driza

Andis Driza

2 Vjollca Malushi

Vjollca Malushi

Tirane me, 22 .02.2021